



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 78

Prishtinë, më 21.9.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Elheme Hetemi, Zef Morina, Berat Luzha, Haset Cakolli, Selvie Halimi, Ali Lajçi, Zulfë Merxha.

Mungoi : Branislav Grbić, Naim Maloku, Myrvete Pantina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zëvendësi i MB Xhabir Morina, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 14.9.2010,
3. Shqyrtimi i çështjeve aktuale me prodhues të rrushit,
4. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për çka komisioni nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 14.9.2010
Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi me zyrtarët e MBPZHR rreth çështjeve aktuale me prodhues të rrushit

Naser Rugova përshëndeti zëvendës ministrin Xhabir Morina dhe mediet të cilëve fillimisht iu përsëriti shqetësimin e kahershëm të komisionit për prodhuesit bujqësor sidomos ata të rrushit që tani protestojnë dhe nuk dinë të ndalen pasi që seriozisht është shkelur tradita dhe krenaria e tyre historike duke mos pasur mundësi të plasojnë prodhimin aty ku duhet, madje edhe duke ju rrezikuar kafshata e gojës, me çka kemi ardhë të gjithë së bashku në një situatë të palakmueshme. Ai shkurtimisht i potencoi problemet kryesore lidhur me këtë temë siç janë

problemet e podrumëve të rrushit por edhe obligimin institucional për të diskutuar mundësinë e daljes me një përgjigje pozitive për këta prodhues të cilët edhe për nesër kanë paralajmëruar protesta radikale.

Xhabir Morina tha se ministria e bujqësisë gjysmën e aktiviteteve të saja i kushton prodhuesve bujqësorë, sidomos degëve të fuqishëm siç është vreshtaria ose hortikultura pasi që në vitet e fundit është vërejt rritje në shitjen e verës duke rënduar edhe më tepër situatën konkurrenca, kostoja e lirë e prodhimit, mospranimi i rrushit nga STONE CASTLE nga 2000 fermer etj, ndaj kjo ministri ka propozuar subvencionin me 4 cent të prodhimit të verës në shkallën e vitit 2009, ndryshimin e ligjit në fuqi për verëra duke trajtuar verën prodhim ushqimor dhe lirim nga akciza, masa të propozuara me donacione dhe grante të produkteve bujqësore nga Qeveria dhe aktivitete tjera studimore sa i përket cilësisë së verës.

Naser Rugova falënderoi për këto informata duke konstatuar që përkundër këtyre nuk kemi asnjë rezultat konkret, ndaj hapi debatin.

Selvie Halimi konsideroi çështjen mjaft alarmante duke konstatuar se prodhuesit si duket kanë pranuar ofertën nga Qeveria por jo edhe ndërmarrja në Rahovec pasi që atje ka mjaft probleme të natyrës teknike për grumbullimin e rrushit (kazanet nuk i plotësojnë kriteret e duhura për qëndrueshmëri më të gjatë etj), por sido që të jetë ministria duhet të zgjidhë problemin mos të mbeten në rrugë prodhuesit bashkë me produktin e tyre duke propozuar ide për ruajtjen e prodhimit vendor, për shitje, të kemi stimulimin adekuat për prodhues vendor etj, ajo uroi për një sukses me një marrëveshje konkrete me stone castle.

Heset Cakolli pyeti për vlerën e gjithëmbarshme të rrushit dhe a është e pranueshme për ndërmarrjen përkatëse, potencoi mirëseardhjen për masat e ndërmarrja nga Qeveria, por megjithatë shfaqti brengën sepse poçes nuk bëhet zgjidhje situata akoma do të radikalizohet me pasoja edhe më të mëdha sesa deri tani. Kemi të bëjmë me mall të gatshëm ndaj Qeveria duhet të tregoj poashtu gatishmëri momentale për të arrit besueshmërinë nga prodhuesit.

Elhame Hetemi tha se kemi të bëjmë me një sfidë për shtetet e rajonit, ndaj fermerët duke pa këtë ata ftojnë në një mobilizim shtetëror i cili duhet të ketë strategjinë për zhvillimet e mëtejme. Subvencionimi duhet të përshëndetet ngase në këtë mandat bujqësia përkrahet aq sa lejohet nga buxheti shtetëror. Për situatën e krijuar duhet një marrëveshje konkrete duke pasur parasysh edhe problemet tjera siç janë konkurrenca jolojale dhe të rishikohet strategjia zhvillimore në bashkëpunim me shoqatat dhe fermerët, ngase ministria e bujqësisë nuk tregton.

Naser Rugova tha se vreshtarë sivjet kanë anuluar edhe festën tradicionale të rrushit me 7 shtator çka assesi nuk është deshtë të ndodhë, ndaj ai edhe një herë shprehu gatishmërinë për ndryshime urgjente legjislative si përfaqësues të popullit me këtë buxhet që ekziston. Ai përkrahu masat e 4 centshit dhe lirim nga akciza të verës, por rekomandoj që qeveria të mbaj një mbledhje urgjente ngase qytetarët këtë e presin.

Zef Morina insistoi që ky problem të zgjidhet jo me proklamim ngase qytetarët janë në hall. Në fakt ai potencoi se kompania stone castle sipas marrëveshjes duhet të jetë i obliguar të grumbulloi rrushin, ngase ska ndryshe si, kjo kompani ka blerë pronën e shtetit ndaj edhe duhet ti kryej obligimet që i takojnë. Qeveria duhet ta shikoj këtë kontratë gjithsesi, përndryshe edhe ai përshëndeti masën e ndërmarr të stimulimit me 4 cent.

Berat Luzha shtoi se ky problem është pasojë e dështimit të privatizimit, ngase menaxhmenti nuk mund të thuhet se ka dështuar ngase masat shtetërore nuk janë askund, të cilat janë shumë të disfavorshme : verëra e Kosovës nuk gjendet në tryezat e jashtme dhe e kundërta : verërat e jashtme gjenden në tryezat tona, dmth Qeveria nuk ka ekonominë politike të mirë. Ka edhe pengesa tjera të shumta, por këto janë kryesore.

Xhabir Morina falënderoi për sugjerimet e komisionit dhe garantoj se përpjekjet e Qeverisë dhe ministrisë janë edhe momentalisht duke vazhduar në tejkalimin e situatës aktuale me prodhuesit e rrushit, nuk përjashtohet asnjë formë e zgjedhjes brenda ditës apo nesër, tha ai.

Naser Rugova mori fjalën për ta përmbyll dhe duke uruar sukses ministrisë dhe Qeverisë duke shprehur gatishmërinë institucionale për çfarëdo ndihme të mundshme dhe kërkoi një

kopje të marrëveshjes me shkrim nëse ajo arrihet ndërsa **Elheme Hetemi** apeloj në gjakftohtësi duke mos dëmtuar askush pronën e askujt ngase protestat e dhunshme nuk qojnë askund.

4. Të ndryshme

Naser Rugova njoftoi komisionin për disa aktivitete në cilësinë e kryetarit të komisionit nga një takim i mbajtur lidhur me mbeturina, ndërkaq për shkak se ai nuk do të prezantoi më vonë, kërkoi nga komisioni të caktohet përfaqësuesi nga ky komision për datën 8,9 dhe 10 tetor kur do të ftohet lidhur me një konferencë rajonale në lëminë e bujqësisë. U caktua **Berat Luzha** të përfaqësoi komisionin në këtë takim, ftesa zyrtare për të cilin takim ende nuk ka arrit.

Për shkak se kryetari i Kuvendit ka kërkuar të përshpejtohet shqyrtimi i projektligjit për mbrojtjen e natyrës, komisioni vendosi që grupi punues në përbërjen momentale të vazhdoi menjëherë punën dhe ta përfundoi gjerë më 29 shtator. **Selvie Halimi** propozoi vazhdimin e punës së grupit nesër në orën 9,00.

Në takimin e grupit punues për projektligjin e prodhimit të duhanit ka kërkuar pjesëmarrje një përfaqësuese ndërkombëtare, për të cilin kryetari mori obligimin ta njoftoi kryesuesin për adresën apo për numrin e telefonit të sajë.

Mbledhja e radhës së komisionit caktohet për 28 shtator kur do të përcaktohen detyrat e komisionit dhe grupi për monitorimin e ligjit për tokën bujqësore.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,00.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova